



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Oda e infermierëve, mamive dhe profesionistëve tjerë shëndetësor të Kosovës  
Komora medicinskih sestara, babica i ostalih zdravstvenih stručnjaka Kosova  
The Kosovo Chamber of nurses, midwives and other health professionals



Bazuar në vendimin e Këshillit Drejtues të OIK në mbledhjen e mbajtur me datë 15.06.2022, Kryetari i OIK-ut shpallë:

Në mungesë të aplikacioneve, vazhdohet afati i publikimit për 5 ditë të shpalljes nr prot. 473 të datës 23.06.2022 me titull:

### Ofertë për Mirëmbajtje të Platformës dhe Uebfaqes së OIK - Zhvillim Softueri

Prishtinë, 01 korrik 2022

Oda e Infermierëve të Kosovës shpallë ofertë për mirëmbajtje të Platformes dhe Uebfaqes së OIK - zhvillim të softuerit. Kandidati duhet të jetë në gjedje të punoj në largësi (Remote) apo sipas nevojës edhe në zyret e OIK dhe të jetë i qasshëm për nevoja urgjente, duhet të demonstroj aftësi të shkëlqyera për zgjidhjen e problemeve, aftësi kodimi me cilësi të lartë dhe aftësi për të menaxhuar kohën tuaj në mënyrë efikase.

OIK aktualisht posedon Uebfaqen zyrtare [www.oik-ks.org](http://www.oik-ks.org) e zhvilluar në platformën Wordpress, si dhe Platformën online për menaxhimin e profesionistëve shëndetësorë [app.oik-ks.org](http://app.oik-ks.org) e ndërtuar në C#, Asp.NET&MSSQL, Bootstrap, Javascript, jQuery.

#### Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Mirëmban dhe zhvillon webfaqen dhe platformën e OIK në bazë të përditësimeve të versioneve të fundit.
- Programon në mënyrë individuale sipas detyrave të deleguara;
- Analizon, dizajnon, zhvillon, teston dhe instalon aplikimin sipas detyrës projektuese;
- Propozon aplikime të reja për implementim;
- Shkrimi i kodit të pastër, dizajnimi i zgjidhjeve për aplikacionet dhe përmirësimi i funksionalitetit;
- Përkujdeset dhe monitoron Windows Serverin;
- Përkujdeset dhe monitoron SQL Serverin;
- Siguron pajtueshmërinë me qeverisjen e të dhënave dhe politikat e sigurisë;
- Koordinon punën e vet me Zyrtarin e TI-së;
- Përdorimi i teknologjive më të përditësuara dhe më të përshtatshme;
- Kujdeset për mirëmbajtjen e programeve të cilat aplikohen;
- Ndjek dhe zbaton politikat dhe procedurat e TI-së;
- Përveç detyrave dhe përgjegjësi të cekura performon edhe në detyra tjera të kërkuara nga Zyrtari i TI-së.

## Kualifikimet :

- Mbi 2 vite përvojë pune në Teknologji Informative
- Njohja e Gjuhës Angleze
- Gjuhët programuese - Asp.NET, Multi threaded applications, PHP, CL, ASP.NET 6.0 , .NET framework 2.0 dhe 3.5, Javascript, jQuery, MSSQL.
- Përvoja dhe njohuri në SQL, MySQL, IIS Server, DB2, LINQ teknologji, AJAX teknologji, AT+Sintaksa, SOAP teknologji, GSM teknologji.

Inkurajohen të aplikojnë të gjithë kandidatët e interesuar, persona fizik dhe juridik të cilët i plotësojnë kushtet e lartëcekura.

Kandidatët e interesuar duhet të dorëzojnë ofertën, kopjen e letërnjoftimit, CV, kopjet e dëshmimeve për kualifikimet e nevojshme arsimore, përvojën e punës, kurset e ndjekura, referencat mbi dëshmin e përvojës së punës në fushën përkatëse si dhe dokumentacionet e tjera të nevojshme të kërkuara në këtë shpallje.

Periodha e ofrimit të shërbimeve do të jetë në periudhë 6 mujore.

Përzgjedhja e ofertuesit do të bëhet sipas ofertës më të lirë dhe më të përshtatshme.

Afati i fundit për dorëzimin e ofertave është 5 ditë nga data e publikimit.

Oferta dhe dokumentet përcjellëse duhet të dërgohen e në zyret e OIK-ut e mbyllur në zarf apo të dërgohet në e-mail: [info@oik-ks.org](mailto:info@oik-ks.org).

Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen

Për më shumë informata mund të kontaktoni në nr. Tel: 038/749-402 apo përmes e-mail: [info@oik-ks.org](mailto:info@oik-ks.org).

Data e publikimit:

01.07.2022



Kryetari i OIK-ut

Naser Rrustemaj